



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 71/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nehat Idrizi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së pankartave mbi hapsirat publike, në seancën e panelit të mbajtur me 28.04.2012, mori këtë:

### V E N D I M

**MIRATOHET** ankesa si e bazuar e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega ne Ferizaj dhe për këtë subjektit politik Aleancës Kosova e Re (AKR), i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 2000 (dymijë) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### Arsyetim

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 27.04.2012, nga subjekti politik LDK, me të cilën pretendohet se subjekti politik AKR, në Rrugën “Dëshmorët e Kombit” në Ferizaj, ka vendosur panon e varur në dy anët e rrugës gjë që është në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP).

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi fotografin e kandidatit për kryetar komune në Ferizaj nga radhët e subjektit politik AKR.

### Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i, e informoi subjektin politik AKR, më datë 27.04.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 28.04.2012, në ora 12:00. PZAP-i, po atë ditë pranoi përgjigjen në ankesë nga subjekti politik AKR, në të cilën thekson se pretendimet e LDK-së janë të pasakta dhe në kundërshtim me vetë provat e bashkangjitura ankesës, andaj nëse shiqohet me kujdes provat, fotot, nga ato asgjë nuk mund të konstatohet se a është e vendosur apo ku është e vendosur, a është montim kompjuterik, apo është ndonjë vend apo qytet tjeter ky panel dhe se një gjë e tillë nuk është dëshmuar me asnjë dëshmitar.

## Veprimet e Ndaluara të Subjekteve Politike

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (b) i LZP-së dhe nenit 3 paragrafi 1 pika (b) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërës si në vijim:*

*b) vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterave, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve.*

### **Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve**

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

*Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:*

*c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).*

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar.**

PZAP-i, përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi ndaj subjektit politik për ndonjë shkelje, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qart se pankarta me sllogane të AKR-së te kandidatit të saj për kryetarë komune të Ferizajt Ramadan Hasani, janë të vendosura në të dy anët e rrugës gjegjësisht mbi rrugët publike, e që PZAP-i konstaton se është në kundërshtim me dispozitat e lartcekura ligjore prandaj më qëllimi të evitimit të shkeljes së lartë cekur dhe në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë**

A nr. 71/2012 më datën 28.04.2012

